

THE ALBANIAN LANGUAGE IN ITS FUNCTION AS AN OFFICIAL LANGUAGE

SHQIPJA, NË FUNKSIONIN E SAJ SI GJUHË ZYRTARE

Bendis PUSTINA¹

¹* Ministry of Culture of Republic of Albania

*Corresponding author e-mail: Bendis.Pustina@kultura.gov.al

Hyrje

Përdorimi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, duke e konsideruar atë si element thelbësor identifikues dhe përcaktues të kombësisë shqiptare, është sanksionuar që në dispozitat e dokumentet e para të shtetit shqiptar. Që në periudhën e Rilindjes Kombëtare shqiptarët u ndërgjegjësuat se, ndryshe nga fqinjët e tyre, përkatësia fetare nuk ishte për ta një komponent kryesor i kombësisë. Në kushtet e pranisë në popullsinë shqiptare të dy feve e katër riteve të ndryshme, ajo që do të ngjallte e do të forconte identitetin kombëtar do të ishte **gjuha shqipe**, mjeti i përbashkët i komunikimit dhe i identifikimit të shqiptarëve nga jugu në veri, nga lindja në perëndim. Gjithashtu, që me idetë iluministe e racionaliste të rilindasit Naum Veqilharxhi, autorit të të parit “Evëtar” të gjuhës shqipe (1844), zë fill ideologjia kombëtare e Rilindjes, parimi i saj udhëheqës se, pa emancipim kulturor nuk mund të ketë emancipim politik.

Kulmi i përpjekjeve të organizuara shtetformuese të shqiptarëve, Lidhja Shqiptare e Prizrenit duke projektuar një shtet kombëtar, trajtoi dhe çështjen e gjuhës së tij. Në pikën 6 të programit të saj, publikuar më 15.9.1878, shkruhej: “*Gjuha osmane të mbetet si gjuhë zyrtare në korrespondencën dhe letërkëmbimin e vilajetit me Portën e Lartë. Megjithëkëtë në këshillat e gjykatave të përdoret gjuha shqipe dhe diskutimet të zhvillohen në këtë gjuhë.*”

Në programin e Lidhjes ishte shtruar dhe zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare në mbarë viset shqiptare, gjë që kërkonte më së pari miratimin e një alfabeti të vetëm. “*Shkoni dhe shpenzoni disa kilogramë ngjyrë duke shkruar vepra mbi historinë tuaj dhe mbi të drejtat tuaja kombëtare, pastaj trokisni në dyert e Fuqive të Evropës*”⁶² – do tu sugjeronte me cinizëm shqiptarëve, kancelari prusian Bismark (Otto Von). Pikërisht, drejt prodhimit të një lëvizjeje kulturore shqipe ose mbi shqiptarët u përqendrua gjithë energjia e patriotëve rilindas pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit.

⁶² Kristo Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, ASHSH, Tiranë 2008, fq. 35.

“Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip”, organizatë e rëndësishme patriotike e arsimore, u themelua në Stamboll nga atdhetarë shqiptarë, pjesë e Komitetit të Stambollit për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare. Në fillim të vitit 1879 komiteti vendosi ngritjen e një grupi që do të merrej me hartimin e një alfabeti të shqipes, ku bënin pjesë: Sami Frashëri, Zija Prishtina, Pandeli Sotiri, Hasan Tahsini, Pashko Vasa, Jani Vreto, Koto Hoxhi. Kryetar i saj u zgjodh një nga ideologët më të rëndësishëm të Rilindjes sonë Kombëtare, Sami Frashëri.

Kjo shoqëri aprovoi alfabetin e shqipes në tetor 1879, që njihet në histori si “Alfabeti i Stambollit”, me të cilin u shtypën shumë tekste e libra që u përdorën nëpër shkollat e shqipes. Dy librat e parë që u botuan me këtë alfabet, janë “Kanonizma e shoqërisë shtypurit shkronja shqip” dhe “Alfabetare e gjuhësë shqip”, të dy botime të vitit 1879. Shoqëria e shkronjave shqipe është ndër të parat përpjekje serioze të hartimit të një alfabeti unik me ndikim latin të gjuhës shqipe dhe hodhi një hap të madh përpara për konsolidimin e mëtejshëm të saj.

Duke përfaqësuar pozitat e iluminizmit shqiptar, në veprën “Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet” Sami Frashëri e quan të vetëkuptueshme, që në shtetin e ardhshëm shqiptar gjuha e shtetit do të jetë shqipja, ndaj preokupohet deri për dialektin ose variantin e shqipes që do të flitet në kryeqytet. Kështu, në kreun VIII “Të ndarët e Shqipërisë” të pjesës “Ç’do të bëhet Shqipëria?” S. Frashëri parashikon edhe se gjuha letrare e shtetit shqiptar do të jetë gjuha që do të flitet në kryeqytetin që do të ndërtohet i ri nga njerëzit që do të mbledhen atje nga të gjitha anët e vendit: “me qënë që ndenjësit’ e ti (*banorët e kryeqytetit* – B.P.) do të jenë të mbledhurë nga gjithë anët’ e Shqipërisë, edhe gjuha që të flitet atje, do të jet’ e përzjerë, që të muntjnë të quhet gjuh’ e përgjithçime e gjuhë letrarishte e gjithë Shqipërisë.”⁶³

Arritja më e rëndësishme gjuhësore në fillimshekullin e kaluar është **njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe**. Megjithëse, në gjithë shtypin shqiptar në prag të Pavarësisë shprehen me forcë kërkesat për ta futur shqipen në veprimtarinë administrative e gjyqësore që zhvillohej në trojet shqiptare, një nga kërkesat e rëndësishme të rilindësve, **lejimi i përdorimit të gjuhës shqipe në administratën shtetërore të katër vilajeteve shqiptare, nuk u realizua**, pasi kërkesa për autonominë e vilajeteve shqiptare u refuzua me forcë nga Porta e Lartë.

Shqipja u bë gjuhë shtetërore vetëm atëhere kur në Shqipëri u shpall një shtet i pavarur, ndaj dokumenti i parë zyrtar me rëndësi madhore i shtetit modern shqiptar mund të konsiderohet **Dokumenti i Shpalljes së Pavarësisë**. Sipas Prof. K. Frashërit:⁶⁴ “Pas duartrokitjeve (për fjalën e Ismail Qemalit-BP) të gjithë delegatët nënshkruan **aktin e shpalljes së pavarësisë**. Akti është shkruar në dy gjuhë, në shqip dhe në turqisht. (Teksti shqip është shkruar me dorën e Luigj Gurakuqit, teksti turqisht me ato të Shefqet Daiut) ... Pas datës vjen teksti shqip:

“Pas fjalëvet që tha Z. Kryetari Ismail Kemal Beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zâ venduan që Shqipëria me sot të bâhet më vehte, e lirë e e mosvarme.”

Pas tekstit shqip vjen teksti turqisht, në të cilin në përkthimin shqip thuhet:

“Pasi u përmendën prej Ismail Qemal Beut Kryetarit të Kuvendit, rreziqet e mjerimet në të cilat ndodhet Shqipëria, Kuvendi me një za pranoi pavarësinë dhe e shpalli Shqipërinë shtet të pavarur e të lir”⁶⁵ Ndërsa sipas përshkrimit të Tajar Zavalanit,⁶⁶ **“Dokumenti i shpalljes së pamvarësisë”, që u botue ma vonë nga Lef Nosi, asht një pasqyrë patetike e gradës së shvillimit politik dhe kulturor të Shqiptarve në at kohë. Teksti shqip përbahe vetëm prej katër rreshtave dhe asht formulue kësisoj: “Pas fjalëvet që tha Z. Kryetari Ismail Kemal Beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një zâ venduan që Shqipëria me sot të bâhet më vehte, e lirë e e mosvarme.”**

⁶³ Sami Frashëri, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1988, f. 72.

⁶⁴ *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, Tiranë, 2008, f. 88 (Po aty ?)

⁶⁵ Po aty, f. 90-91.

⁶⁶ Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë, 1998, f. 224.

Mandej vijnë dy rreshta të shkruajtun me alfabetin e turkishtjes së vjetër. Ma në fund, nënshkrimet e delegatve, ose të atyne qi dijshin me shkruajtë shqip. Bile duket se njani e ka vue firmën me germa turqishte. Gjithashtu edhe data e dokumentit asht karakteristike e kohës kur asht hartue mbasi përbahet nga dy shifra: 1912 të kalendarit gregorian dhe 1328 të kalendarit arab.”

Më lart përmendëm se nga të gjitha kërkesat apo objektivat e shtruara nga rilindësit në lidhje me zhvillimin e gjuhës shqipe, vetëm njëra nuk kishte pasur rast të realizohej, **shpallja e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare e shtetit dhe administratës shqiptare**. Por nga ana tjetër, me gjithë arritjet e shënuara gjatë Rilindjes Kombëtare, gjuha shqipe nuk ishte bërë e aftë për t’u përdorur në veprimtarinë e degëve të ndryshme të administratës shtetërore. Terminologjia e organizimit të administratës, e gjyqeve dhe e ushtrisë, që janë ndër funksionet kryesore të një shteti, nuk ishte përpunuar. Veç kësaj, një gjuhë e njësuar, sidomos në arsim dhe në veprimtarinë e administratës është një ndër kërkesat më të para për një shtet.

I takoi Qeverisë së Vlorës të hidhte hapat e parë në drejtim të kësaj ndërmarrjeje mjaft të vështirë dhe të zgjatur, pasi kalimi nga një sistem administrativ shekullor në gjuhën osmane me terminologjinë e tij përkatëse, në një sistem të ri të orientuar nga modele perëndimore dhe në gjuhën kombëtare nuk mund të kryhej veçse gradualisht në të gjithë territorin shqiptar. Gazeta “Përlindja e Shqipërisë” (1913-1914), zëdhënëse e shtetit të pavarur shqiptar, më 23 shtator 1913 boton **vendimin e Qeverisë së Vlorës mbi caktimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare dhe hapjen e shkollave shqipe prej shtatorit 1913**. Ky vendim kishte një rëndësi të madhe jo vetëm për vetë gjuhën shqipe, që fitonte me këtë rast një funksion të ri shumë të rëndësishëm shoqëror, por njëkohësisht edhe për forcimin e karakterit të pavarur e të autoritetit të shtetit të ri shqiptar.

Në verën e vitit 1913 Qeveria nisi marrjen e masave të para për ngritjen e shtetit dhe të administratës së tij, ku akti më i rëndësishëm është: **“Kanuni i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë”**, që u botua nga fundi i nëntorit 1913, ndërsa më parë ishte miratuar Kanuni i Zhurisë (13 maj 1913), akti i parë legjislativ në fushën e organizimit gjyqësor kombëtar. Procesi i parë gjyqësor në gjuhën shqipe mendohet të jetë shkruar në fund të vitit 1912 nga Kristo Floqi (autor i disa vëllimeve me shkrime juridike).

Me formimin e Ministrisë së Arsimit në Qeverinë e Përtashme të Vlorës, përpjekjet për zhvillimin e arsimit kombëtar në gjuhën shqipe u ngritën në një nivel më të organizuar. Një ndër sfidat kryesore që qëndronin para Qeverisë qe krijimi i rrjetit arsimor. Në vitin 1913 u ngritën shumë shkolla fillore në të gjithë vendin, e veç kësaj Qeveria shtroi si objektiv të hidheshin themelet e një sistemi arsimor me karakter kombëtar e laik.

Nëpërmjet artikullit të rëndësishëm “Gjyqësia në Shqipërië” të Kristo Floqit *“Kryetar i Gjykatariëvet Politike e Penale të Vlorës”*, njihemi me problematikën e përdorimit të shqipes në jurisprudencë e zyra dhe përkthimin e terminologjisë gjyqësore.⁶⁷ Po citojmë disa rreshta prej tij, ku analizohen shkaqet përse gjuha shqipe, megjithëse e shpallur zyrtare, nuk po përdorej ende: *“Guverna edhe veçanërisht ministori’ e Drejtësiës dha urdhër akoma të përdoret edhe gjuha Shqip, si gjuhë zyrtare nëpër zyrat offiqiale, po mjerisht ky urdhër mbet vetëm i shkruar më kartë edhe as fare i zbatuar në veprim.... shkaku i parë është që të 9/10 e nëpunësve nuk dinë të shkruajn’ e të këndojnë gjuhën shqip dhe i dyti, që më të shumët e nëpunësve s’duan të përdoret gjuha shqip. Këta të dytit ndahen në tre kategoria. 1) Në ata që pandehin se gjuha shqip s’është e plottë edhe s’mbush gjithë nevojat, 2) në ata që dinë pak të shkruajnë... dhe 3) në ata që pandehin se mos këto shkronja gjauure (!) prishin fenë muhamedane etj. etj. gjepura”*.

⁶⁷ “Përlindja e Shqipërisë“ dt. 3/16 gusht 1913, f. 3, dhe vazhdimi i artikullit më dt. 7/20 gusht 1913, f. 2.

Përveç këtyre si shkak për mospërdorimin e shqipes në gjykatat, K. Floqi përmendte dhe zbatimin e “*nomeve*” (ligjeve) të Turqisë, të vështira për t’u përkthyer në shqip, e njoftonte punën e tij mbi hartimin e “*kushteve të gjuhës gjyqore*”, të cilat për lehtësi kuptimi do të botoheshin të shpjeguara në tre-katër gjuhë. Edhe shoqëria civile e kohës do të kontribuonte fuqimisht në futjen e gjuhës shqipe në sferat zyrtare të përdorimit. Kështu, mjaft domethënës e shembull i shkëlqyer (për kohën) i vetorganizimit profesional në shërbim të emancipimit të jurisprudencës shqiptare, është një dokument i Lidhjes gjyqësore “Drita”. Në “Rregullimin” (Statutin) e kësaj shoqate të vitit 1913 shkruhet:

“Rregullimi i Lidhjes Drejtësore ‘‘Drita’’

*“Duk me u-ndarë Shqipëria prej Turqiës, për të qënur një Shtet i veçanët e European, e, duk me u-parë nevoja për një rojtje me përparim e qytetërim, njerëzit e Drejtësiës të ndodhur në Vlorë në këtë Kryeqytet të përtashëm të Shqipëriës, edhe duk me lidhur besë shqipëtarisht, biseduan e vëndosën të bashkohen me shoqi-shoqin duk me formuar një lidhie të fortë, për përparimin e mburimin e gjyqësiës në Shqipëri, edhe përgjithësisht përparimin e Kombit me anën e Drejtësiës. Përandaj për të vepëruar regullisht, ngrejtim e nxuar në dritë këtë regullim”.*⁶⁸

Synimi i kësaj lidhjeje ishte përhapja e zhvillimi i drejtësisë në Shqipëri, por duke i vënë një theks të veçantë: “*me anën e gjuhës kombëtare Shqipes*”. Ndaj më poshtë zgjerohet qëllimi e specifikohen objektivat:

“Veçanërisht Lidhia Drejtësore ‘‘Drita’’ ka për me vepëru këto qëllime:

I Të futurit e gjuhës shqip midis anëtarëve të saj, ashtu që ç`do anëtar të dijë të shkruajë dhe të ligjërojë gjuhën shqip sa më mirë e pa të metë.

II Të formuarit të skanjeve teknike të gjyqësiës e të përdorurit e të zbatuarit në gjyqësië të gjuhës shqip ligjore pas rregullave letrale.

III Të çpikurit e Kanuneve të nevojshëm për Shqipëriën apo të përkëthyerit në gjuhën shqip Kanunet e botës qytetëruar...

Për vite me radhë në fonde të ndryshme të institucioneve të administratës shtetërore, që ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit apo në periodikë të hershëm të fond-arkivit të Bibliotekës Kombëtare ndeshemi me problemin e konsolidimit të shqipes si gjuhë zyrtare e kësaj administrate, treguese e pranisë dhe forcës së shtetit të ri shqiptar në formim e sipër. Për qëndrimin ndaj gjuhës shqipe nga Qeveria e Durrësit (Esat Pashë Toptanit) mund të gjykojmë nga ky fakt: në gazetën “**Shqypnia e re**” të Shkodrës, në prill 1914, botohet artikulli “**E mjera gjuha shqype**” i Haki Glinës,⁶⁹ nga Durrësi, në të cilin flitet kundër vendimit të administratës shtetërore (Qeverisë së Durrësit- BP) që lejonte që gjuha turke të njihej ende si gjuhë zyrtare. Aty shkruhet: “*Pra sot në shtetin Shqiptar e vetëma gjuhë që do të përdorohet në qeveri është shqypja askush nukë munt t’a ket kurajo që të përdërojë gjuhën turqisht në shtetin t’onë...*

Kur u dëgjue mandata se gjuha turqisht për pesë vjet u njoh Zyrtarisht pa fjalë gjaku na u bë krejt ujë, dhe kshu s’ditmë se si t’a gjykojmë këtë trathëtiqë po na bën qeveria e Durrësit?! “Autori, pasi thekson se lufta më e rreptë që kanë patur shqiptarët me qeverinë turke ka qënë çështja e gjuhës, shpreh gëzimin për çlirimin e Shkodrës më 7 mars të atij viti dhe siguron se: “...nasjonalistët e Shkodrës nukë do të njohin gjuhën turqisht si gjuhë zyrtare kure nonjëherë...”

Në fondin Lef Nosi në AQSH ruhet një letër e vitit 1914 dërguar atij, sipas të cilës: “*korçarët janë kundër turqishtes si gjuhë zyrtare – siç do qeveria e Durrësit...*”⁷⁰

⁶⁸ AQSH, *Kryesia e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës*- F. 145, D. XIII-1- Lidhja gjyqësore “Drita”, fl. 1-12

⁶⁹ *Shqypnia e re*, Shkodër, 5 prill 1914, fleta 2

⁷⁰ AQSH, Lef Nosi – *Korresp. F. 32, v. 1914, D. 55, fl. 138*

Qendrimi ndaj gjuhës dhe kulturës shqiptare që ka dalluar dhe administratat e huaja, që kanë qeverisur pjesë të caktuara të territoreve shqiptare, më pak apo më shumë kulturalisht liberale, apo dhe përkrahëse të elementit identitar shqiptar, pavarësisht qëllimeve politike apo strategjive të tyre afatgjata. Administrata franceze nëpërmjet Protokollit të Krahinës Autonome të Korçës (10 dhjetor 1916), neni VIII nje dhe sanksionon se: “**Gjuha zyrtare do të jetë shqipja**”, ndërsa edhe më favorizues ishte qëndrimi i administratës austro-hungareze, ku spikat kontributi i shënuar në drejtim të përkrahjes së kulturës e gjuhës shqipe që kulmon me “**Komisinë letrare**”.

Një arritje madhore për zhvillimin dhe njësimin e gjuhës letrare shqipe, përbën “Komisioni letrar shqip”, që u mbledh në Shkodër në vitin 1916. Ndërsa kushtet historike, sociale, kulturore e arsimore ishin pjekur, aktivistët shqiptarë shfrytëzuan koncesionin e bërë nga Komanda Ushtarake Austriake për hapjen e shkollave shqipe për të kërkuar më shumë, themelimin e Komisionit Letrare të Shkodrës.

Komisioni nënvizoi si detyrë themelore lëvrimin e gjuhës letrare shqipe dhe zhvillimin e letërsisë shqiptare. Ky komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh, krijuar për të ndihmuar në formimin e një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, vlerësoi variantin letrar të mesëm, si një urë në mes toskërishtes dhe gegërishtes dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e tij, të cilat ndikuan në njësimin e shqipes së shkruar, si dhe “...krijimin i një terminologjie shkollore dhe të administratës së njësuar”.⁷¹ Ndërsa sipas Mustafa Merlika (Kruja) për gjuhën e përbashkët “*ma shumë ka ba Komisia në tri vjet se sa qeveritë shqiptare në dyzet vjet.*”⁷²

Vendimet e Komisionit letrar shqip për gjuhën letrare e për drejtshkrimin e saj, u miratuan më vonë edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) e u praktikuan në vijim. Rëndësia që i jepej aso kohe përdorimit të shqipes në aktet zyrtare, i cili nuk ishte arritur ende plotësisht, del edhe shumë më vonë, në një telegram të vitit 1921, me anë të të cilit Prefekti i Gjirokastrës Kol Tromara njofton me shqetësim Ministrinë e Brendshme se Myftiu i Gjirokastrës prokurat dhe **letërgjykimet** i paraqet ende turqisht, me një shënim të shkurtër shqip. Këtu gjejmë të arsyetuar se: “*Neve jo vetëm për mënyrë të papëlqyrë po edhe për arsye politike nuk pranojmë as një akt greqisht ose turqisht*”.

Fakti, që ky nuk është një problem anësor, i cekur vetëm në një dokument, por një shqetësim serioz, duket në gjithë praktikën shkresore të lidhur me të. Kështu, në fondin “Ministria e Punëve të Brendshme” të AQSH, viti 1921, dosja 756, gjendet një letërkëmbim i tërë mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Gjyqit të Lartë të Sheriatit, Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Prefekturës së Gjirokastrës, etj. në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe në korrespondencën zyrtare.

Përfundime

1. Lufta për të konsoliduar gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare të komunikimit në të gjithë administratën shtetërore shqiptare ka ecur paralelisht e ndoshta me po aq përpjekje, sa ajo për sigurimin e tërësisë territoriale dhe vendosjen e autoritetit të shtetit të ri shqiptar në kufijtë që iu caktuan ndërkombëtarisht nga Konferenca e Londrës (1913).

2. Politikat gjuhësore të ndjekura nga qeveritë e ndryshme në Shqipëri në çerekun e parë të shekullit XX, ngritja e një administrate të bashkuar shqiptare, zhvillimi i sistemit arsimor shqiptar dhe përpjekjet e profesionistëve për krijimin e terminologjisë administrative, zyrtare, juridike etj. rezultoi në përmbushjen e funksionimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, si dhe në përmirësimin e stilit administrativ të kësaj gjuhe.

⁷¹ Shih: M. Domi *Ndre Mjeda si gjuhëtar dhe lëvrues i gjuhës shqipe*, “Drita”, 20.11.1966

⁷² Shih rev. *Shkëndija*, 1940, nr. 2, f. 7.

Dokumente madhore mbi caktimin e gjuhës zyrtare në shtetin shqiptar si dhe përdorimin e saj si gjuhë zyrtare (deri në 1939):

- Statuti i parë Themeltar i Shtetit Shqiptar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (1914)
- Protokoll i Krahinës Autonome të Korçës (10 dhjetor 1916)
- Statuti Themeltar i Shtetit (Kongresi i Lushnjës 1920)
- Vendimi “Mbi djalektin zyrtar” (1923)
- Statuti i Republikës (1925)
- Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1928)
- Statuti i Mbretërisë (1939)
- Statuti i Mbretërisë pas pushtimit italian.

Referencat

- [1]. *Historia e popullit shqiptar II*, Akademia e Shkencave Shqipërisë, Tiranë, 2002.
- [2]. *Fjalori enciklopedik shqiptar*, ASHSH, Tiranë 2009, 3 vëll.
- [3]. Lef Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historis tonë kombëtare*, Nr. 1, Elbasan, 1924.
- [4]. Kristo Frashëri, *Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë*, ASHSH, Tiranë 2008.
- [5]. Sami Frashëri, *Vepra 2*, ASHSH, Tiranë, 1988.
- [6]. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis Tiranë, 1998*.
- [7]. Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914* Tiranë, 1978.
- [8]. Arben Puto, *Shqipëria politike 1912- 1939* Toena 2009.
- [9]. Artan Haxhi; Tefë Topalli. *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër 1999.
- [10]. Miço Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)* Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2005.
- [11]. Teki Selenica, *Shqipëria më 1937*, Tiranë, 1937.
- [12]. Gazeta “Përlindj’ e Shqipnies” V. 1913, 1914, “Taraboshi” 1913.